



Pranuar / Dorezuar Priljenor/Prodato Received/Delivery	29.12	1	viti god year
Organ Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	6419/2021		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.936/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.936/2021 të datës 15.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr."Migjeni", Nr.3, Rahovec, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.936/2021 e datës 15.11.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të nxjerr akt administrativ për njohjen e të drejtës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për ankuesin për periudhën e transferimit të përkohshëm sipas Vendimit Nr.165/2021 të datës 26.02.2021.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në pozitën Zyrtar për Regjistrim në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Rahovec, me datë 15.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5477/2021 të regjistruar me numër A.nr.936/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore për njohjen e të drejtës për



kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit me rastin e transferimit të përkohshëm nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve në Rahovec, në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Malishevë, sipas Vendimit me numër reference 165 të datës 26.02.2021 të lëshuar nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB).

Këshillim i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.11.2021 ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit, ndërsa me datën 30.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat tjera ndërlidhur me lëndën.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën A.nr.936/2021 me numër të protokollit 5477/2021 të parashtruar në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 16.11.2021; Emalin e datës 15.11.2021; Emalin e datës 15.10.2021; Kërkesën e datës 20.04.2021 me numër të protokollit 11/21; Kërkesën e datës 12.07.2021 me numër të protokollit 21/21; Emalin e datës 15.10.2021; Emalin e datës 12.11.2021; Emalin e datës 10.11.2021; Emalin e datës 04.11.2021; Vendimin e datës 26.02.2021 me numër 165; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.11.2021 ; Përgjigjen në ankesë të datës 30.11.2021 me numër të protokollit 5703/2021; Aktin e emërimit të datës 31.01.2013; Vendimin e datës 26.02.2021 me numër të protokollit 165/1; Vendimin e datës 12.11.2021 me numër të protokollit 1224; Kërkesën e datës 25.02.2021 me numër të protokollit 455; Emalin e datës 15.10.2021;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit DRAPSH/ARC-2/13 të datës 31.01.2013 është konstatuar se ankuesi është i emëruar në pozitën e punës Zyrtar për Regjistrim në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Rahovec.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes Vendimit me numër të protokollit 165/2021 të datë 26.02.2021 ka transferuar përkohësisht ankuesin nga Qendra për Regjistrim të Automjeteve në Rahovec, në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Malishevë. Transferimi i ankuesit është bërë mbi bazën e dispozitave ligjore të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi përmes e-mailit të datës 15.10.2021 drejtuar Drejtoreshës së Drejtoratit për Regjistrimin e Automjeteve në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin Civil, ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën e transferimit të përkohshëm, gjegjësisht periudhën 01.03.2021 - 12.11.2021. Sipas shkresave të lëndës, ankuesi në afatin ligjor nuk ka marr përgjigje në kërkesën e tij, andaj i njëjti me datë 15.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 52 paragrafi 4 më të cilin është paraparë se: *Nëpunësit civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një lokacion tjetër, i cili është më i largët se sa vendi i tij i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin., si dhe dispozitat e Rregullores*



(QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, gjegjesisht nenin 9 paragrafi 2, ku përcaktohet se: *Nëpunësit civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një lokacion tjetër, i cili është më i largët se sa vendi i tij i rregullt i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin, dhe rrjedhimisht konstatoj se nëpunësi civil i cili transferohet me kërkesë të institucionit në një vend tjetër të punës i cili është më i largët se vendi i tij i përhershëm i punës, ka të drejtë në realizimin e shpenzimeve të udhëtimit.*

Andaj duke marr parasysh konstatimin se ankuesi sipas Akt Emërimit DRAPSH/ARC-2/13 të datës 31.01.2013 është emëruar në pozitën e punës Zyrtar për Regjistrim në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Rahovec, dhe me Vendimin me numër të protokollit 165/2021 të datë 26.02.2021 i njëjti për interes të institucionit është transferuar përkohësisht në Qendrën për Regjistrim të Automjeteve në Malishevë, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor për realizimin e shpenzimeve të udhëtimit gjatë periudhës se transferimit të përkohshëm, është i bazuar.

Kështu që bazuar si me lartë obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë se Regjistrimit Civil që të nxjerr akt administrativ për njohjen e të drejtës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për ankuesin për periudhën e transferimit të përkohshëm sipas Vendimit Nr.165/2021 të datë 26.02.2021.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.936/2021

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

*Procesmbajtëse*

Jeton KOÇA

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë se Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së